**PROTOKOLLI PËR ZBATIM TË**

**Marrëveshjes**

**ndërmjet**

**Qeverisë së Republikës së Kosovës**

**dhe**

**Qeverisë së Republikës së Maqedonisë**

**për Ripranimin e Personave të cilët Qëndrojnë pa Autorizim**

Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Kosovës

dhe

Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Maqedonisë

me poshtë të referuara si "PALËT KONTRAKTUESE",

Në pajtim me Nenin 17 të Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për Ripranimin e Personave të cilët Qëndrojnë pa Autorizim (me poshtë e referuar si 'Marrëveshja')

Bien dakord si në vijim:

**Neni 1**
**Autoritetet Kompetente**

1. Autoritetet kompetente për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje do të jenë:

Për Republikën e Maqedonisë:

Për pranimin, dorëzimin dhe kthimin e përgjigjeve për kërkesat për ri pranim ose transit

Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës se Maqedonisë
Byroja për Siguri Publike

Sektori për Çështje të Kufijve dhe Migracionit
Adresa: 9 "Dimche Mirchev" Rruga, 1000 Shkup, Republika e Maqedonisë
telefoni ++389 2 3238034
Fax: ++389 2 3143335
Email: mvr_sgrm@moi.gov.mk

Për pranimin dhe dërgimin e njoftimeve të shkruara për transfer

Ministria e Punëve të Brendshme
Zyra e Sigurisë Publike
Sektori për Çështje të Kufijve dhe Migracionit
Qendra Rajonale për Çështje të Kufijve –Veri
Adresa: 9 "Dimche Mirchev" Rruga, 1000 Shkup, Republika e Maqedonisë;
Telefoni: ++389 2 3238040
Fax: ++389 2 3288039

Për Republikën e Kosovës:

Për Operacionet e Ripranimit

Ministria e Punëve të Brendshme

Departamenti i Shtetësisë, Azilit dhe Migracionit
Rruga "Luan Haradinaj"
Ndërtesa e re e Qeverise se MPB-se
10000 Prishtinë – Kosovë

Tel. +381 38 200 19 130
+381 38 200 19 590
+381 38 200 19 739
+381 38 200 19 579
Fax.
Email: mpb.riatdhesimi@rks-gov.net
mpb.riatdhesimi1@rks-gov.net
mpb.riatdhesimi2@rks-gov.net
mpb.riatdhesimi3@rks-gov.net
mpb.riatdhesimi4@rks-gov.net

Për Operacionet e Transitit

Ministria e Punëve të Brendshme
Policia e Kosovës
Drejtoria për Migrim dhe të Huaj
Rruga "Luan Haradinaj"
10000 Prishtina - Kosovë

Tel. +381 38 50 80 1422;
Fax. +381 38 50 80 1222;
Email: drejtoriapermigrim@kosovopolice.com

2. Të gjitha ndryshimet shtesë në lidhje me autoritetet kompetente apo detajet që lidhen me ta duhet të dorëzohen drejtpërdrejt ndërmjet autoriteteve kompetente të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij Neni.

**Neni 2**
**Dokumentet Tjera**

1. Nëse Shteti kërkues konsideron që dokumentet tjera, të cilat nuk janë listuar në Shtojcat 1 dhe 2 të këtij Protokolli, janë të nevojshme për përcaktimin e shtetësisë së personit që do të ripranohet, dokumentet e tilla mund të dorëzohen te Shteti që i kërkohet se bashku me kërkesën për ripranim.

2. Autoriteti kompetent i Shtetit që i kërkohet do të vendos rreth asaj se a do të merren parasysh dokumentet e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij Neni, gjatë shqyrtimit të kërkesës për ripranim.

**Neni 3**
**Intervista**

1. Në rastet kur, në pajtim me Nenin 6, paragrafi (3) të Marrëveshjes, shtetësia e personit i cili duhet të ripranohet, nuk mund të përcaktohet më dokumentet e listuara në Shtojcat 1 dhe 2 të këtij Protokolli, do të zbatohen njëra ose të dy procedurat në vijim:

   a) Autoritetet Kompetente të Shtetit Kërkues mund të kërkojnë një intervistë, në Misionin Diplomatik apo Konsullor të Shtetit që i kërkohet, me qëllim të marrjes së informatave mbi shtetësinë e tij/saj.

b) Autoritetet Kompetente të Shtetit kërkues mund të kërkojnë që intervista nga ekspertët e Shtetit që i kërkohet, të mbahen në territorin e saj. Shpenzimet e udhëtimit dhe të akomodimit të ekspertëve do të barten nga Shteti kërkues.

2. Nëse në bazë të intervistës dhe duke marrë parasysh të gjitha deklaratat e personit të intervistuar, duke përfshirë njohuritë e tij / saj për vendin, gjuhën e tij / saj dhe të gjitha informatat tjera, nuk do të jetë e mundur për të përcaktuar shtetësinë e vendit pritës, arsyet përkatëse duhet t'i komunikohen me shkrim autoritetit kompetent të Shtetit Kërkues.

3. Nëse në bazë të informacioneve të dhëna gjatë intervistës, me ndihmën e të cilave mund të përcaktohet shtetësia e personit në fjalë, autoriteti kompetent i Shtetit Kërkues, duhet të dorëzojë kërkesën për ripranim tek autoriteti kompetent i Shtetit që i kërkohet, në përputhje me Shtojcën 5 të këtij protokolli.

**Neni 4**
**Procedurat e Ripranimit dhe Transitit**

1. Për Ripranim dhe Transit, Palët Kontraktuese do të caktojnë pikat e kalimit kufitar si në vijim:

   a) Për Republikën e Maqedonisë:

   SP për PKK Aeroporti " Aleksandri i Madh" Shkup
   SP për PKK "Dolno Blace"
   SP për PKK "Jazince "

   b) Për Republikën e Kosovës:

   Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës "Adem Jashari"

   PKK "Hani i Elezit"

   PKK "Globoçica".

   Palët Kontraktuese duhet menjëherë ta informojnë njëra tjetrën për çdo ndryshim të pikave të kalimit kufitar, të listuara në paragrafin 1 të këtij Neni.

## Neni 5
## Shoqërimi i Personit i cili duhet të Ripranohet apo të Kalojë Transit

1. Ky nen ka të bëjë me të gjitha llojet e shoqërimit (p.sh. policor, shëndetësor apo social);

2. Nëse personi, i cili është në proces të ripranimit apo kalimit transit do të shoqërohet nga një eskortë, Shteti Kërkues duhet t'i jap informatat vijuese: emrat, mbiemrat, rangjet, pozitat e personave shoqërues, lloji, numri dhe data e lëshimit te pasaportave si dhe kartelat identifikuese të shërbimit, përmbajtjen e misionit të tyre.

3. Shoqëruesit janë të obliguar që t'i binden legjislacionit të Shtetit që i kërkohet.

4. Shoqëruesit nuk do të bartin armë dhe objekte tjera të ndaluara në territorin e Shtetit që i kërkohet.

5. Shoqëruesit duhet të jenë në rroba të thjeshta, të mbajnë pasaporta të vlefshme si dhe kartelat identifikuese të shërbimit, si dhe urdhrin për mision, të lëshuar nga autoriteti kompetent i Shtetit Kërkues, gjithashtu edhe aprovimin për transit të lëshuar nga Shteti që i kërkohet.

6. Për numrin e personave të cilët do jenë shoqërues të personave, dakordohen paraprakisht autoritetet kompetente, rast pas rasti.

7. Autoritetet kompetente do të bashkëpunojnë me njëra tjetrën për të gjitha çështjet që lidhen me qëndrimin e shoqëruesve në territorin e Shtetit që i kërkohet. Nëse është e nevojshme, autoritetet kompetente të Shtetit që i kërkohet duhet t'ia sigurojnë shoqëruesit mbrojtjen e duhur dhe ndihmën gjatë realizimit të detyrave të tyre, në përputhje me legjislacionin kombëtar.

## Neni 6
## Shpenzimet

Shpenzimet e bëra nga Shteti që i kërkohet , që lidhen me procesin e ripranimit dhe transitit, të cilat duhet të barten nga Shteti Kërkues, në pajtim me Nenin 13 të Marrëveshjes, do të rimbursohen nga Shteti Kërkues, brenda tridhjetë (30) ditëve pas dorëzimit të dëshmisë së shpenzimeve.

**Neni 7**
**Gjuha**

Autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese, gjatë zbatimit të kësaj Marrëveshjeje, do të komunikojnë në mënyrë gojore dhe të shkruar në gjuhën Angleze.

**Neni 8**
**Hyrja në fuqi, Kohëzgjatja, Ndryshimet, Plotësimet dhe Përfundimi**

1. Ky Protokoll hyn në fuqi, datën e njëjtë kur hyn në fuqi Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për ripranimin e personave të cilët qëndrojnë pa autorizim.

2. Ky protokoll mund të ndryshohet, plotësohet me pëlqimin e shkruar e të dyja Palëve Kontraktuese. Ndryshimet dhe plotësimet e Protokollit do të hyjnë në fuqi ditën kur ato nënshkruhen.

3. Në rast të pezullimit të përkohshëm të zbatimit të Marrëveshjes, sipas paragrafit 1 të këtij neni, që mund të jetë tërësisht apo pjesërisht, ky Protokoll do të zbatohet në përputhje me rrethanat.

**Neni 9**
**Shtojca**

Shtojcat prej 1 deri në 6 janë pjesë përbërëse e këtij Protokolli.

Bërë në Shkup, Maqedoni më 4.12.2017 në dy kopje origjinale, secila në gjuhën Maqedone dhe në gjuhet zyrtare të Republikës së Kosovës (Shqip dhe Serbisht), si dhe në gjuhën Angleze. Në rast të mospërputhjeve në interpretim të këtij Protokolli, versioni në gjuhën Angleze do të mbizotërojë.

| | |
|---|---|
| **Për** | **Për** |
| **Qeverinë e** | **Qeverinë e** |
| **Republikës së Kosovës** | **Republikës së Maqedonisë** |
| **Flamur Sefaj** | **Oliver Spasovski** |
| **Ministër i Ministrisë së Punëve të Brendshme** | **Zëvendës Kryeministër dhe Ministër i Ministrisë së Punëve të Brendshme** |

Shtojca 1

## LISTA E DOKUMENTEVE
## DORËZIMI I TË CILAVE KONSIDEROHET TË JENË DËSHMI E SHTETËSISË

(Neni 2 paragrafi (1) dhe Neni 6 paragrafi (1) i Marrëveshjes)

Për Republikën e Maqedonisë:

- Pasaporta shtetërore e vlefshme e çdo lloji;
- Letërnjoftimet shtetërore të vlefshme (te certifikuar).

Për Republikën e Kosovës:

- Certifikata e lindjes e vlefshme;
- Certifikata e shtetësisë;
- Letërnjoftimi i vlefshëm;
- Pasaporta e vlefshme.

Shtojca 2

**LISTA E DOKUMENTEVE**
**DORËZIMI I TË CILAVE KONSIDEROHET TË JETË PROVË PRIMA FACIE E SHTETËSISË**

(Neni 2 paragrafi (1), dhe Neni 6 paragrafi (2) i kësaj Marrëveshje)

Për Republikën e Maqedonisë:

- Dokumentet të cilëve u ka kaluar afati, të renditura në shtojcën 1 apo fotokopja e të njëjtave;
- Patentë - shoferët apo fotokopja e të njëjtave;
- Certifikatat e lindjes apo fotokopjet e të njëjtave;
- Deklaratat e dëshmitarëve;
- Deklaratat e shkruara të bëra nga personi në fjalë;
- Deklaratat e dhëna nga personi dhe gjuha e folur, duke përfshirë rezultatet e çdo lloj të verifikimit zyrtar për përcaktimin e shtetësisë së personit;
- Certifikatat e shtetësisë si dhe dokumentet tjera zyrtare, ku provohet Shtetësia apo sigurohet ajo, apo kopjet e tyre;
- Të dhënat biometrike të personit, siç janë shenjat e gishtërinjve;
- Çdo dokument tjetër, i cili mund të ndihmoj në përcaktimin e shtetësisë së personit në fjalë.

Për Republikën e Kosovës:

- Dokumentet të cilëve u ka kaluar afati, të renditura në Shtojcën 1 apo fotokopja e të njëjtave;
- Patentë-shoferët apo fotokopja e të njëjtave;
- Broshura e Forcës së Sigurisë së Kosovës;
- Deklaratat e dëshmitarëve;
- Deklaratat e shkruara të bëra nga personi në fjalë;
- Gjuha e folur nga ai apo ajo, duke përfshirë edhe rezultatet e testit zyrtar (gjuhësor);
- Të dhënat personale biometrike siç janë shenjat e gishtërinjve, retina e syrit dhe irida, struktura e zërit, struktura e fytyrës si dhe të dhënat e përmasave të duarve;
- Rezultatet e testit te ADN-së;
- Çdo dokument tjetër i cili mund të ndihmoj në përcaktimin e shtetësisë së personit në fjalë.

Shtojca 3

## LISTA E DOKUMENTEVE QË KONSIDEROHEN SI DËSHMI PËR RIPRANIMIN E SHTETASVE TË VENDEVE TË TRETA DHE PERSONAVE PA SHTETËSI

(Neni 3 paragrafi (1), dhe Neni 7 paragrafi (1) i Marrëveshjes)

- Vulat hyrëse/dalëse apo lejet e ngjashme në dokumentet e udhëtimit të personit në fjalë, apo dëshmi tjetër të hyrjes/daljes;
- Dokument të vlefshëm, shembuj të vizave dhe/apo lejeqëndrimit të lëshuar nga Shteti që i kërkohet për lejimin e qëndrimit në Shtetin që i kërkohet;
- Biletat me emër dhe/apo lista e udhëtarëve të aeroplanit, trenit, autobusit apo kalimeve me anije, të cilat tregojnë prezencën dhe itinerarin e personave në fjalë, në territorin e Shtetit që i kërkohet;
- Deklaratat zyrtare të personit në fjalë, në procedura gjyqësore apo administrative, të dhëna pranë autoriteteve kompetente në Shtetin që i kërkohet.

Shtojca 4

**LISTA E PËRBASHKËT E DOKUMENTEVE, TË CILAT KONSIDEROHEN SI DËSHMI PRIMA FACIE E KUSHTEVE PËR RIPRANIM TË SHTETASVE TË VENDEVE TË TRETA DHE PERSONAVE PA SHTETËSI**

(Neni 3 paragrafi (1), dhe Neni 7 paragrafi (2) i Marrëveshjes)

- Dokumente, certifikata dhe çdo lloj fature (p.sh. faturat e hotelit, kartelat e mjekut/stomatologut etj), të cilat qartazi tregojnë që personi në fjalë ka qëndruar në territorin e Shtetit që i kërkohet.

- Informacionet në lidhje me identitetin dhe/apo qëndrimin e personit, të siguruara nga autoritetet ndërkombëtare apo organizatat jo - qeveritare;

- Raportet/konfirmimet e informatave nga anëtarët e familjes, bashkudhëtarët etj.

Pala kërkuese:_____
Vendi dhe data:_____
Numri: _____
Palës që i kërkohet:_____

**Shtojca 5**

**APLIKACIONI PËR RIPRANIM**
**Në përputhje me Nenin 5 të Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Maqedonisë**
**dhe**
**Qeverise së Republikës së Kosovës për Ripranimin e Personave të cilët Qëndrojnë pa Autorizim**

A. Të dhënat personale
1. Emri dhe mbiemri (nënvizo mbiemrin)

_____

2. Mbiemri i vajzërisë:

_____

3. Data dhe vendi i lindjes:

_____

4. Përshkrimi i gjinisë dhe fizik (gjatësia, ngjyra e syve, shenjat dalluese etj.)

_____

_____

5. Gjithashtu i njohur si (emrat e mëparshëm, emrat e tjerë të përdorur/ me të cilat njihet personi apo emrat e rremë)

_____

6. Shtetësia dhe gjuha:

_____

7. Të dhënat e prindërve:

Babai_____
Nëna_____
8. Statusi i shtetësisë ☐ i martuar☐ i pa martuar ☐ i divorcuar☐ i vejë

Nëse personi është i martuar:
Emri i bashkëshortit: _____
Emri dhe mosha e fëmijëve(nëse ka) _____
_____
_____
_____

9. Adresa e fundit tek Palët kërkuese kontraktuese, si dhe në Shtetin që i kërkohet

_____

B. Të dhënat personale për bashkëshortët (nëse nevojitet)

1. Emri dhe mbiemri ( nënvizo mbiemrin):

_____

2. Mbiemri i vajzërisë:

_____

3. Data dhe vendi i lindjes:

_____

4. Gjinia dhe përshkrimi fizik (gjatësia, ngjyra e syve, shenjat dalluese etj.)

_____

5. Gjithashtu i njohur si (emrat e mëparshëm, emrat e tjerë te përdorur/ me të cilat njihet personi apo emrat e rremë)

_____

6. Shtetësia dhe gjuha:

_____

C. Të dhënat personale të fëmijëve (nëse janë të nevojshme)
1. Emri dhe mbiemri (nënvizo mbiemrin):

_____

2. Data dhe vendi i lindjes:

_____

3. Gjinia dhe përshkrimi fizik (gjatësia, ngjyra e syve, shenjat dalluese etj.)

_____

4. Shtetësia dhe gjuha:

_____

D. Dëshmitë e dorëzuara:

_____

_____

_____

E. Vërejtje:

_____

_____

_____

(nënshkrimi) (vula)

_____

Shtojca 6

## KËRKESA PËR TRANSIT

**Në përputhje me Nenin 12 të Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për Ripranimin e Personave të cilët Qëndrojnë pa Autorizim**

A. Detajet personale

1. Emri i plotë (nënvizoni mbiemrin)

Fotografia

_____

2. Mbiemri i vajzërisë:

_____

3. Data dhe vendi i lindjes:

_____

4. Gjinia dhe përshkrimi fizik (gjatësia, ngjyra e syve, shenjat dalluese, etj):

_____

5. Gjithashtu i njohur si (emrat e mëhershëm, emrat tjerë të përdorur/ në bazë të të cilëve njihet apo emërohet dhe emrat e rremë):

_____

6. Kombësia dhe gjuha:

_____

7. Lloji dhe numri i dokumentit të udhëtimit:

_____

B. OPERIMI TRANSIT

1. Mënyra e kalimit transit

☐ Në rrugë ajrore ☐ Në rrugë tokësore

2. Cekeni destanconin final

_____

_____

3. Shtetet e tjera ku do kaloni transit

_____

_____

4. Pika e propozuar e kalimit kufitar, data, koha e dërgimit si dhe eskorta eventuale

_____

5. Pranimi i garantuar në ndonjë shtet tjetër transit dhe në shtetin që e keni destinacionin final (Neni 11 (2))

☐ po ☐ jo

6. Arsye tjera për refuzim te transitit (Neni 11 (3))

☐ po ☐ jo

C. REMARKS

_____

_____

_____

(signature) (stamp/seal)